



Dr. Mimoza Zeneli

Lektore

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

Tirana Business University College

Dr. Mimoza Zeneli është Përgjegjëse e Departamentit të Informatikës Ekonomike, pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në Kolegjin Universitar “Tirana Business University ” (TBU). Ajo është diplomuar në vitin 1991 Bachelor në Statistikë, Universiteti i Tiranës, si dhe zotëron Diplomë të integruar në “Statistikë”. Në vitin 2008 diplomohet për Master i Shkencave në Financë, Universiteti i Tiranës, dhe në vitin 2016 fiton gradën “Doktor i Shkencave” në Financë – Kontabilitet. Që nga viti 2007 Dr. Zeneli është angazhuar në akademi, si lektore e jashtme pranë disa universiteteve publike dhe jopublike, me fokus Statistikën e Përgjithshme apo Aplikative, Analizën e të Dhënave, Organizim - Drejtim Biznesin, si dhe Menaxhimin e Projekteve.

Dr. Zeneli ka kryer studime dhe kualifikime të vazhdueshmë, brenda dhe jashtë vendit. Ajo ka kontribuar për kërkimin shkencor kryesisht në fushën e vlerësimit të ndikimit të rregullimeve të Mikrokreditimit dhe Sistemit Fiskal, duke botuar artikuj të rëndësishëm në revista të njohura, brënda dhe jashtë Shqipërisë. Për një periudhë 5 vjeçare ajo ka qenë anëtare e Bordit Editorial të Revistës “ Demografia”, si dhe anëtare e Shoqatës së Demografëve dhe Shoqatës së Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme.

Dr. Zeneli ka një përvojë pune 28 vjeçare pranë disa prej institucioneve të rëndësishme publike dhe private në vend në pozicione drejtuese dhe ekzekutive. Në institucionet publike qendrore Dr. Zeneli ka një eksperiencë të çmuar në fushën e privatizimit, si: Kryetare e Agjencisë së Privatizimit, dega Tiranë dhe Kavajë. Ajo ka një eksperiencë 15 vjeçare në fushën e Programimit të Dokumenteve Strategjike, Buxhetore dhe Administrimit të Pronës, si eksperte në institucione të qeverisjes qendrore. Që nga viti 2008 ajo është Vlerësuese e licencuar për Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme, duke ju atashuar si eksperte e jashtme vlerësimi bankave më të rëndësishme tregtare në Shqipëri. Dr. Zeneli ka një eksperiencë të rëndësishme në menaxhimin dhe koordinimin e projekteve me financim të huaj.